NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.133/2006 në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik" bëhet kjo ndreqje:

Ishte:

c) kur ka një nevojë urgjente, për shkaqe jashtë kontrollit apo parashikimit të autoritetit kontraktor, që kanë të bëjnë me fatkeqësi natyrore: tërmete ose përmbytje dhe kur afati kohor limit për procedurën e hapur, të kufizuar apo me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit, nuk mund të realizohet. Rrethanat e krijuara, për të justifikuar urgjencën, në asnjë rast nuk duhet të shkaktohen nga autoriteti kontraktor d"he në asnjë rast nuk duhet të përdoren të për justifikuar realizimin e investimeve komplekse, të cilat zgjasin më shumë se një vit buxhetor.

Bëhet:

c) kur ka një nevojë urgjente, për shkaqe jashtë kontrollit apo parashikimit të autoritetit kontraktor, që kanë të bëjnë me fatkeqësi natyrore dhe kur afati kohor limit për procedurën e hapur, të kufizuar apo me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit, nuk mund të realizohet. Rrethanat e krijuara, për të justifikuar urgjencën, në asnjë rast nuk duhet të shkaktohen nga autoriteti kontraktor dhe në asnjë rast nuk duhet të përdoren të për justifikuar realizimin e investimeve komplekse, të cilat zgjasin më shumë se një vit buxhetor.